

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
**ÇESHTJE RRETH POLITIKES PER NGACMIMIN E PALIGJSHEM**

**ÇFARE ESHTË NJE NGACMIM I PALIGJSHEM?**

Ngacmimi është një veprim me fjalë, me shkrim, në mënyrë grafike ose fizikisht që lidhet me gjininë, racën, moshën, ngjyrën, orientimin seksual (të njohur ose të supozuar), shprehjen e identitetit të gjinisë (të njohur ose të supozuar), origjinës kombëtare, besimit fetar, paaftësisë, gjendjes socialekonomike dhe/ose bindjeve politike.

**KUSH JANE SHEMBUJT E NJE SJELLJEJE TE NDALUAR?**

- *Kërcënimi ose ngacmimi, frikësimi ose sulmi fizik ndaj një nxënësi tjetër*
- *Shkrimi, që përmban gjuhë fyese e cila ofendon të tjerët*
- *Bërje e lojrave fyese ose tallje me emrin, apo ofendime për të tjerët*
- *Krijon shabllone negative ose veprime armiqësore, që janë fyese për të tjerët*
- *Krijon material me shkrim apo grafikë të cilët përmbajnë komente ose shabllone, të cilat afishohen, qarkullohen ose shkruhen në rroba, që janë ofenduese për të tjerët*

**DREJTORIA NDALON TE GJITHA FORMAT E NGACMIMIT PER NXENESIT E DREJTORISE**  
**SI DUHET TE SILLENI KUR JU APO TE TJERE QE NJIHNI NGACMOHENI?**

**Raportimi i Rasteve të Ngacmimit:**

- Nxënësit ose prindërit/kujdestarët e nxënësve, të cilët janë ngacmuar, ose kanë qënë dëshmitarë të skenave të tilla, duhet të raportojnë menjëherë për këto incidente te drejtori i shkollës apo i ngarkuari për këtë qëllim, ose te çdo pjeshtar i personelit të shkollës, përfshirë mësuesit, këshilltarët, trajnerët dhe administratorët.
- Çdo anëtar i personelit që merr një raportim të tillë, duhet të njoftojë menjëherë drejtorin ose të ngarkuarin e tij
- Nëqoftëse një sjellje e tillë vazhdon, ose nëse shkolla nuk ndërmer veprime, nxënësit ose prindërit/kujdestarët duhet t'a raportojnë incidentin në linjën e hapur telefonike të drejtorisë 215-400-SAFE

**SI DO TE ZHVILLOHEN NGJARJET KUR RAPORTOHET NJE RAST I NGACMIMIT?**

Do të bëhet një investigim i plotë dhe i shpejtë i të gjithë raporteve të ngjarjes. Nëse akuzat janë të vërteta, Drejtori ose i ngarkuari do të vazhdojnë si më poshtë:

- Njoftojnë nxënësin i cili është ngacmuar për rezultatet e investigimit;
- Rishikojnë përcaktimin e ngacmimit dhe politikën e Drejtorisë për ngacmimin;
- Dënojnë rastin në fjalë, sipas rasteve të ofendimeve dhe ashpërsisë të sjelljes; dhe
- Njoftojnë prindërit e nxënësit(ve) që kanë ngacmuar, përfshirë veprimet që ata kanë ndërmarrë dhe pasojat.

**ÇFARE NDODH ME NXENESIT QE NGACMOJNE?**

**Pasojat për Shkeljet:**

- Ndaj nxënësve që shkelin politikën për ngacmimet e paligjshme do të merren masa disiplinore në përputhje me Kodin e Sjelljes të Nxënësit.
- Nëse vepra e parë është veçanërisht e rëndë, kjo mund të çojë në një pezullim afat gjatë nga shkolla (4-10 ditë); referim për vendosje në një program edukimi alternativ; ose përjashtim nga shkolla.

**Për më shumë informacion, kontaktoni Zyrën e Nxënësit, për Disiplinën, Dëgjimet dhe Përjashtimet, me numrin e telefonit (215) 400-4230**